

REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E NOTERISË

TIRANE

NR. 10107 Rep.

NR. 3247 Kol.

KONTRATË E FORMËS "BOT"
(NDËRTIM – OPERIM - TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT
"SHUTRI"

Në TIRANE, më datë 2, muaji SHTATOR, viti 2013 (dy mijëdymbëdhjete), para meje noter JULIAN ZHELEGU, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANE, me adresë Zr. "PJETER RROGARDH", u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 14.09.2011, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncension të hidrocentraleve "Shutri", dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhje konkurruese që i jepet shoqërisë", përfaqësuar nga përfaqësuar nga Ministri z.Florjon Mima, i datëlindjes madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Pashkashesh" shpk & "Aurora Konstruksion" shpk & "Arlita B" shpk, që në vijim do të quhet "KONCESIONARI", i formuar sipas marrëveshjes nr. 2276 Kol, nr.3666 Rep, datë 25.10.2011 me këto të dhena:

Shoqëria "Pashkashesh" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT K51718007A dhe date 13.12.2000 regjistrimi;

Shoqëria "Aurora Konstruksion" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT K02017003I dhe date 17.08.2000 regjistrimi;

Shoqëria "Arlita B" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT J61814029N dhe date 16.09.1995 regjistrimi;

Shoqëria "Pashkashesh" shpk, me prokurë nr.3669 Rep, nr.2279 Kol., date 25.10.2011 dhe me prokurën nr.3668 Rep, nr.2278 Kol., date 25.10.2011 është përcaktuar si shoqëri kryesuese dhe përfaqësohet nga administratori Z. Rezart Balliu, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr.

Faqe 1 nga 22

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqipërisë

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.
3. Vlerëson formën “BOT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të sipërpërmendur, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës perzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit përkatës në pellgun ujembledhes të burimeve të Shutrise e perroit të Shutrenjes, rrethi Mat, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr., datë, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Shutri”, dhe miratimin e bonusit ne procedurën perzgjedhëse konkurruese qe i jepet shoqerise”, dhe miratimin e bonusit ne procedurën perzgjedhëse konkurruese qe i jepet shoqerise”, dhe bien dakord për sa më poshtë:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Përkufizime dhe interpretime**

1. Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtëme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:
 - 1.1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
 - 1.2. **Ligji “Për Koncesionet”**: Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar.
 - 1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 - 1.4. **Koncesionari**: Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Pashkashesh” shpk & “Aurora Konstruksion“ shpk & “ Arilta B” shpk, ku shoqëria “Pashkashesh” shpk është përcaktuar si shoqëri kryesuese, me seli ne fshatin Pashkashesh, Tirane.
 - 1.5. **Hidrocentrali**: Hidrocentrali “Shutri”, me vendndodhje në pellgun ujembledhes te burimeve te Shutrise e perroit te Shutrenjes, rrethi Mat, me fuqi të instaluar 1300 (njemijetreqind) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 6 140 000 kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, bazenën e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.
 - 1.6. **Objekti**: Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentralit dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.7. **Investimi**: Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentralit, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
 - 1.8. **Punimet**: Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit Shutri, në përputhje me projektin e zbatimit.
 - 1.9. **Fillimi i punimeve**: Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8.2 të kësaj kontrate.
 - 1.10. **Vënia në punë e hidrocentralit**: Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
 - 1.11. **Kontratat**: Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt operimin e hidrocentralit dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
 - 1.12. **Leje dhe Liçenca**: Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
 - 1.13. **Operimi**: Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
 - 1.14. **Tarifa koncesionare**: Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
 - 1.15. **Llogaritja e afateve**: Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të

njëtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

- 1.16. **Data Efektive:** Nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga palët.
 - 1.17. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
 - 1.18. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
 - 1.19. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licensë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
 - 1.20. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, i ndryshuar.
 - 1.21. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
 - 1.22. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguroese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
 - 1.23. **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, që do të ndihmojnë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.
 - 1.24. **"E Drejta për Kalim"** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjese të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
 - 1.25. **"Shesh"** do të thotë sheshi që gjendet ne rrjedhen e perroit te Shutrenjes, në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde.
 - 1.26. **"Gëzim i qetë"** do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.
2. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:
- 2.1. Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
 - 2.2. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
 - 2.3. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
 - 2.4. Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
 - 2.5. Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.

2.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

2.6.1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;

2.6.2. Oferta e Koncesionarit;

2.6.3. Dispozitat e kësaj kontrate;

2.6.4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;

2.6.5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Neni 2 Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për koncesionet", i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e hidrocentralit "Shutri" dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3 Karakteristikat e hidrocentralit

3.1. **Hidrocentrali "Shutri"** do të ndërtohen në pellgun ujembledhes te burimeve te Shutrise e perroit te Shutrenjes, rrethi Mat, me këto karakteristika:

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e veprës së marrjes 154 m.m.n.d
 - o Kuota e godinës së centralit 125 m.m.n.d
- Fuqia e Instaluar 1300 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 6 140 000 kwh

Neni 4 Periudha e Koncesionit

4.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e shtyrjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore periudha e koncesionit do të shtyhet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të “Vlerës për Para”, “IRR” apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.

4.2.2. Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Të drejtat koncesionare - Sheshi

5.1. Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Aftin:

- i. të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin;
- ii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iii. me mbarimin e Aftit t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të Objekteve Ekzistuese të shtuara, nese ka; si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjydhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, “**të Drejtat Koncesionare**”).
- iv. Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çertifikatat CER,

5.2. Dhënia e Sheshit

Pamvarësisht nga sa parashikohet në Nenin 5.1 më sipër, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të çertifikatave siguroese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim në përputhje me nenin 15 të kësaj kontrate.

Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin në pellgun ujembledhes te burimeve te Shutrise e perroit te Shutrenjes, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim përkundrejt Koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.

Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, si rregull merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura, për të ndihmuar këtë të fundit ne marrëdhëniet me te tretet, ne menyre qe te shmanget çdo pengesë, që mund të haset në kuadër te cpronimeve apo çdo lloji tjetër pengese, ne lidhje me servitutet dhe uzufruktet perkatese, per te siguruar koncesionarit nje gezim te qete te sheshit, për realizimin e punimeve dhe operimin normal per realizimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm, kur moszgjidhja e pengesave te mesiperme, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse, për shkak të veprimeve te fajshme te Koncesionarit.

Ne rast kur sheshi eshte prone shteterore midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit lidhet nje kontrate perdorimi tip userfrukt.

Neni 6

Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.

6.2. Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 7.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 7.2. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licensë, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 7.3. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës.
- 7.4. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 7.5. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Koncesionarit.
- 7.6. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.
- 7.7. Gjate shfrytëzimit të lumit të Shutrise dhe burimeve të Shutrise të respektohet niveli normal 128.5 m.m.n.d. dhe niveli maksimal 129.5 i liqenit të Ulzes.
- 7.8. Të respektohen kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për përdorimin e ujerave të burimeve të Shutrise për ujitje nepermjet kanaleve ujitese Urake 100 litra uje/sekond, kanali ujites Shutri 20 litra uje/sekond dhe kanali ujites Bruc 20 litra uje/sekonde, gjate periudhes 15 Maj – 15 Shtator.

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

- 8.1. Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionere”, duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
 - ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit “Shutri”, tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj Kontrate);
 - iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni;
 - iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetem nga Koncesionari.
- 8.2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
 - 8.3. Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
 - 8.4. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;
 - 8.5. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
 - 8.6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentralit “Shutri”, me fuqi totale të vendosur ne sasine jo më pak se 1300 kW;
 - 8.7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
 - 8.8. Të kërkojë nëse e gjen me interes dhe të përshtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktues sipas pikës 5 të nenit 7, më sipër.
 - 8.9. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe te ktheje ambientin, me shpenzimet e veta, ne situaten e meparshme (para ndotjes).
 - 8.10. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
 - 8.11. Të mbajë te informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;

- 8.12. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- 8.13. Koncesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës;
- 8.14. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi;
- 8.15. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi për rezervat ujore.
- 8.16. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 8.17. Koncesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë që i përket pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet, po ashtu me qëllim marrjen e certifikatave të gjelbërta apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, që ka të bëjë me prodhimet e energjive të rinovueshme, duke patur parasysh parashikimin e pikës 8 të këtij neni.
- 8.18. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kesaj veprimtarie.
- 8.19. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 Vlerësimi i Investimeve

- 9.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 139 666 667 (njqindetridhjetenentemilion e gjashtëqindëgjshtedhjetegjashtëmije e gjashtëqindëgjshtedhjeteshtate) lekë, sipas Aneksit nr. 1 bashkelidhur, nga te cilat 45 000 000 (dyzetepesemilion) lekë do të investohen në makineri e pajisje.
- 9.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
 - pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të permiresohet por duke ruajtur të pandryshuar kuotat/termat e percaktuara në kete marreveshje.
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;
 - në cdo rast parametrat teknike të projektit si dhe afatet do të mbeten të pandryshueshme, me përjashtim të rasteve që parashikon neni 10.3.

Neni 10 Programi punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

- 10.1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të Lejes Zhvillimore Komplekse. Aplikimi për pajisjen me Leje Zhvillimore Komplekse, do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektzbatimit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues.
- 10.2. Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e marrjes së lejeve. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit. Afati i ndertimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur.
- 10.3. Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonësave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11 **Testimi i veprës**

- 11.1. Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e hidrocentralit. Testimi do të fillojë brenda 45 (dyzetepese) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 45 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

Neni 12 **Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit**

- 12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- 12.1.1. Kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit sipas nenit 10.1. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;
- 12.1.3. Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat e Shoqërisë së re koncesionare, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

- 12.1.4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njqind) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14 si dhe hidrocentralin siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit apo shoqërisë koncesionare.
- 12.1.5. Kur shoqëria e re koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi në paafesi paguese ose situata të tjerë të ngjashme, për faj të koncesionarit. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.6. Kur Koncesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/disa nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë.
- 12.1.7. Kur nuk siguron financimin e projektit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari:

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje serioze të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk e korrigjon këtë shkelje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni.

12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë:

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

- 12.3.1. Megjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Koncesionarit për aplikim për leje, licenca ne përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, koncesionari nuk është pajisur me to për arsye ligjore, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.
- 12.3.2. Vazhdimi i saj bëhet i pamundur jo për faj të koncesionarit.
- 12.3.3. Në rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kësaj kontrate.
- 12.3.4. Kur ka shkelje serioze nga ana tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe menjëherë të parashikuar në kontratën e koncesionit.

12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;

- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorigjimit të shkeljes brenda 60 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston, me kusht që të ketë paguar kompesimin e rene dakort me negociim midis dy paleve.

12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

12.6.1. Njoftimi-i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çënojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të ketij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 60 (gjashtedhete) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se nuk është bërë i mundur korigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit ne momentin e fitimit te gares;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguroese mbi hidrocentralin.

12.6.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të koncesionarit.

Në rast të zgjidhjes së Kontrates për faj të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj Koncesionarit.

12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të Autoritetit Kontraktues, ky i fundit duhet t'i paguajë koncesionarit, vlerën e investimit të kryer deri në momentin e zgjidhjes së kontratës minus vlerën e amortizimit të veprës, si dhe fitimin e munguar, që Koncesionari mund të nxirrte deri në përfundim të afatit të kësaj kontrate (35 vjet), siç llogaritet në paragrafin më poshtë:

Fitimi i munguar = $(35 - \text{Numrin e viteve deri në datën e Zgjidhjes}) \times 0,6 \times (\text{Kthimi Mesatar mbi Kapitalin për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes}) \times (\text{vlera mesatare e Kapitalit të Vet për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes})$.

12.7.3. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga secila palë

Në rast zgjidhjeje të kontratës nga secila palë, sipas pikës 12.3.1 të këtij neni, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj koncesionarit.

Neni 13 Kontratat

13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 17.2 të kësaj kontrate. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.

Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktuesin e propozuar:

- i. Emrin e tij dhe adresën;
- ii. Qëllimet për të cilat nënkontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nënkontraktuesi i propozuar; dhe
- iii. Vlerën e nënkontratës
- iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

13.2. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

13.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14
Sigurimi i kontratës

- 14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 13 966 666 (trembedhjetemilion e nenteqindgjashtedhjetegjashtemije e gjashtëqindgjashtedhjetegjashte), që përbën 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 14.2. Koncesionarit i lejohej të ç'ngurtësojë këtë vlerë, bazuar në parashikimet e nenit 11, brenda 30 (dhjete) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë.
- 14.3. Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me perfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit.

Neni 15
Sigurimet

- 15.1 Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbaje dhe ripërterije ato garanci sigurimi të kerkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, dhe do t'i percjelle, ose do të kujdeset që t'i percillen Autoritetit Kontraktues kopjet e çertifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 15.2 Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 15.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguroresi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të perdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguroresi do të paguajë për kompesimin e dëmit do të perballohet nga koncesionari.
- 15.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.5 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.
- 15.6 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16
Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarife koncesionare të barabartë me vlerën e 6 % të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në raport të drejtë me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.

16.2 Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, Koncesionari do të riinvestojë 60 % të vlerës së investimit për makineri dhe pajisje, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim.. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17
Kufizimet


- 17.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari ose shoqëria e re koncesionare duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast pales se trete do ti transferohen dhe detyrimet apo te drejtat e percaktuara ne kontraten e koncesionit.
- 17.2 Koncesionari nuk ka të drejtë të nënkontraktoje asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera me te medha se 50 % te vleres se investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nën-kontraktore sipas kësaj Kontrate.
- 17.3 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontrate.

Neni 18
Raportimi

- 18.1. Koncesionari është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19
Legjislacioni i zbatueshem

19.1. Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.



Neni 20
Forca Madhore

20.1. “Forca madhore” nënkupton cdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së çënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së çënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- a. kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga pala e çënuar;
- b. pala e çënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së çënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
- c. ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e çënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
- d. pala e çënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakort palës tjetër (pala e pacënuar)

20.2. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:

- i. Katastrofat e natyres, përmytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
- ii. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

20.3. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4.2.2 të kësaj kontrate.

20.4. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit :

- i. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- ii. kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

20.5. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njera tjetrës dhe secila palë do të perballojë kostot e veta.

- 20.6. Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

- 21.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar.

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 22.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 22.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 22.3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 23

Sanksionet

- 23.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
- i. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0.05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
 - ii. Për moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.3, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara.

iii. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë.

23.2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- i. Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 6 140 000 KWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, duke patur parasysh se në këtë rast Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare prej 6 % (për sasi prej 368 400 kWh/vit). Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkaqe të tjera të ligjshme (jo për faj të koncesionarit), Koncesionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar; nderkaq, Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën koncesionare, në vlerën prej 6 % të prodhimit të realizuar.
- ii. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur, përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate, Koncesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshtë:

Shuma e penalitetit = Prodhimi vjetor i energjisë elektrike x Fuqia e painstaluar (në %) x Vitet e operimit si të llogaritura në oferte x Çmimi i shitjes së energjisë elektrike vendosur nga ERE në momentin e kryerjes së testimit të veprës sipas nenit 11 të kësaj kontrate x Fee Koncesionare (në %).

Ky penalitet do të aplikohet në momentin e testimit të veprës në përputhje me nenin 11 të kësaj kontrate.

23.3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 2 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0.005% të vlerës së investimit për çdo ditë vonese.

23.4. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.

23.5. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkates, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

23.6. Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron koncesionarin nga permbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

23.7. Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontrates parashikuar në nenin 14 më sipër, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteve, Koncesionari do t'a plotesoje këtë shumë, rast pas rasti.

Neni 24
Rregullimi i shkeljeve

- 24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë, ai menjehere ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
- 24.2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospermbushja e detyrimeve.

Neni 25
Transferimi i Aseteve

- 25.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.
Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 25.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshtim në favor të Autoritetit Kontraktues:
- i. hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
 - ii. ndërtesa, makineri, paisje;
 - iii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
 - iv. të drejtat kontraktore ;
 - v. dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
 - vi. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;
- 25.3. Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.
Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve ka ardhur si pasojë direkte e saj.
- 25.4. Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë kontratë, do të mbarojë me transferimin e projektit.
- 25.5. Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.

Neni 26
Mbarimi i kontratës

- 26.1. Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 të kësaj kontrate.

- 26.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27 Konfidencialiteti

- 27.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28 Ndryshime

- 28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 28.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29 Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit që do të perdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjitikës
Blvd. Zogu i Parë, Nr. 1001,
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Pashkashesh" shpk.
Adresa: Fshati Pashkashesh, Tiranë

Neni 30
Rregjistrimi i Kontratës

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga

z. Florjon MIMA



KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive
“Pashkashesh” shpk & “Aurora
Konstruksion” shpk & “Ariлта B” shpk

Përfaqësuar nga :

z. Rezart BALLIU

